

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1308 Prot.

Tiranë, më 28.12 2016

VENDIM Nr. 146, datë 20.12.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 14 të datës 20.12.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*", Shtesë e Fushatës së Parë, KM 145-KM 139+674, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Lorenc Bejko,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*", Shtesë e Fushatës së Parë, KM 145-KM 139+674.
2. Për zonat me potencial të lartë arkeologjik, fushat në juglindje të fshatit Uznovë dhe pikërisht në pikat e mëposhtme:
 - Pika kilometrike 144+860 (APL 545)
 - Pika kilometrike 144+360 (APL 547)
 - Pika kilometrike 143+710 (APL 560)

të kryhen sondazhe arkeologjike, sipas konceptit të paraqitur, nën mbikëqyrjen e ASHA. Raporti i sondazheve arkeologjike, të paraqitet në KKA e radhës.

3. Për zonat me potencial të ulët arkeologjik, të vijojnë punimet e ndërtimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 76, datë 15.07.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145".
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO